

Fleta teknike: **ThermoProtect**

Përshkrimi i produktit

ThermoProtect është shtresëzim i gatshëm për fasada, mbi bazën e teknologjisë së membranave reflektuese.

Lëndët përbërëse

Dispersion Polyakrylati, dioksid titani, okid zingu, Kaolin, Karbonat Kalçiumi, Silikate, ujë, Glykol Propyleni, Celulozë, lëndë konservuese

Grupi i produktit / Kodi - GIS

BSW20

Vlejshëm të dhënat e fletës aktuale të sigurisë.

Fusha e përdorimit

ThermoProtect është një shtresë mbrojtëse rezistente për pothuajse të gjitha sipërfaqet e jashtme. Për shkak të përbërjes së veçantë të *ThermoProtect* rezulton një seri fushash energjike të përdorimit në mbrojtjen termike në dimër dhe verë.

Veçoritë specifike të produktit

Frymëmarës difuziv, rezistencë të lartë ndaj ndikimeve agresive mjedisore, si smogu dhe ozoni, pa nxjerje gazesh apo lëndësh të tjera, pa lëndë tretëse, qëndrueshmëri të lartë ndaj rrezeve UV dhe ndikimeve të motit, reflektues, i qëndrueshëm në tonet e ngjyrave, komod nga pikëpamja termike. Rregullues lagështie në sipërfaqet difuzive dhe absorbuese

Të dhënat e materialit:

- Vlera e rezistencës në difuzionin e avujve të ujit DIN 52615
- niveli i tharjes: $sd = 1,3$
- diapazoni i lagështisë: $sd = 0,7$
- dendësia: $1,05 \text{ kg/dm}^3$ sipas ISO 2811-1
- sjellja ndaj zjarrit: C-s1, d0
- rezistenca kimike: sipas kërkesës

Rregullat për lidhjet organike të çlirueshme (EG)

Vlera kufitare që nga 01.01.2010 për lëndët lyerse, toni mat (Prod.-Kat. c) për mure të jashtme me përbërje lëndësh ndërtimore minerale = 40 g/l .

Ky produkt përmban $< 3 \text{ g/l VOC}$.

Udhëzim përpunimi

ThermoProtect mund të shtrohet në të gjitha sipërfaqet e qëndrueshme, ato minerale, si p.sh. suva e jashtme, suva me lidhje organike dhe bojra të vjetra të qëndrueshme. Për të siguruar veçoritë energjike duhet të sigurohet një bazament (sipërfaqe) frymëmarëse (difuzive).

Përgatitja e bazamentit

Plastmas:

Testoni aftësinë ngjitëse

Metale:

Sipas metalit dhe kërkesave, lyejeni me një shtresë bazë (primer) *ClimateCoating® RustPrimer* ose *ClimateCoating® ZincPrimer*

Shtresat e vjetra të paqëndrueshme:

Në varësi të materialit që do të hiqet lajeni, largojeni shtresën kimikisht ose me ujë me presion të lartë apo paisje me avull të nxehtë

Sipërfaqe bazë që pengojnë ngjitjen:

Shpëlajeni, pastrojeni me sulcione bazike, kruajeni

Sipërfaqe bazë minerale thithëse të lagështisë:

Shtresëzoni me sulcion bazë (astar) *ClimateCoating® FixPlus*

Përpunimi

Përpunimi mund të kryhet me furçë, rul ose sprucim. Në rastin e lyerjes për herë të parë janë të nevojshme dy shtresa. *ThermoProtect* është i gatshëm për lyerje. Nëse punohet me sprucim duhet të respektohen rregullat e prodhuesit të aparateve të sprucimit. Në sipërfaqe shumë të ashpra ose gjatë përdorimit të aparateve me sprucim mundet që viskozitetin e materialit ta rregulloni me pak ujë. Gjatë përpunimit duhet të kihet kujdes, që temperatura e ajrit dhe e objekteve të mos qëndrojë nën 5°C . Kjo vlen edhe për të gjithë kohën e tharjes. Meqenëse në rastin e përdorimit të materialeve lidhëse bëhet fjalë për materiale që kristalizohen nën rrezet UV, duhet patur parasysh që të ketë dritë dhe rrezatim të mjaftueshëm përpara përdorimit dhe pas një kohe të gjatë ndërprerje të punës materiali duhet të përzihet shkurt me përzierës elektrik.

Koha e tharjes ndërmjet dy shtresave të bojës është 12 orë.

Konsumi

Konsumi i *ThermoProtect* është afërsisht 330 ml/m^2 për një lyerje dyherëshe mbi një sipërfaqe të lëmuar, e që nuk thith shumë lagështirë.

Sasitë e përdorimit janë të varura nga struktura dhe aftësia thithëse e sipërfaqes dhe kjo duhet kontrolluar me anë të një lyerje provë. Për optimizimin e efikasitetit termike në mbrojtjen ndaj nxehtësisë në verë në varësi të klimës dhe sipërfaqes bazë janë të nevojshme trashësi më të mëdha të shtresave të bojës.

Pastrimi i veglave të punës

Rulat, furçat dhe aparatet e sprucimit duhet të shpëlahen menjëherë pas përdorimit.

Tonet e ngjyrave

ThermoProtect mund të tonohet me sistemin e ngjyrave NCS, RAL dhe *ClimateCoating®* Edition 1.

Toni i ngjyrës duhet testuar përpara përdorimit.

Magazini transporti

ThermoProtect magazinohet dhe transportohet në temperatura të freskëta, por jo në ngrirje. Enët e thyera mbyllini mirë dhe mundësisht përdorini sa më shpejt. I qëndrueshëm deri në 12 muaj pas datës së prodhimit.

Forma e furnizimit

5; 12,5; 19 Litra

Madhësi të tjera enësh sipas kërkesës.

Hedhja poshtë (flakja)

Mos lini që mbetjet e produktit të përfundojnë në kanalizime, ujra sipërfaqësore apo në brendësi të tokës.

Jepini për riciklim vetëm enët boshe. Mbetjet e produktit dorëzohini vetëm tek vendet përkatëse të grumbullimit.

Kodi i mbeturinës- Nr. 080120 sipas listës së mbetjeve të BE.

Udhëzim sigurie

Përmbajtja e fletës teknike nuk krijon marrëdhënie kontraktuale ligjore.

Përdoruesi apo blerësi duhet të testojë në çdo rast, në kushte praktike, aftësinë e materialit para përdorimit.

Mos lini që mbetjet e produktit të përfundojnë në kanalizime, ujra sipërfaqësore ose nëntokësore. Mbajeni larg prej ushqimeve, pijeve dhe ushqimit e kafshëve. Mbrojeni nga ngacmimet e fëmijëve. Sipërfaqet që nuk duhen trajtuar duhet të mbrohen me anë të masave të duhura. Mbrojeni sytë dhe lëkurën nga sprucimi. Mos thithni me anë të frymëmarrjes mjegullën që lind nga sprucimi gjatë punës.

Me daljen e një flete teknike të re, e kushtëzuar nga përmirësimi i produktit, të dhënat e paraqitura humbasin vlefshmërinë e tyre.

Të dhënat e paraqitura janë vlerësuar nga SICC Coatings GmbH në laborator dhe praktikë si vlera udhëzuese. Informacionet mbi produktin rrjedhin nga njohuritë më të mira dhe përkohësisht me nivelin e sotëm të teknikës. Ndikimet mjedisore, materialet e punës, aparaturat e aplikimit qëndrojnë jashtë ndikimit tonë dhe kështu jashtë përgjegjësisë tonë. SICC®2021